

Njoftim për vend vakant pune

Shoqëria “Albpetrol SH.A”, shoqëri me pronësi publike, e cila operon në fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe marketimit të naftës dhe gazit, kërkon të punësojë në pozicionin e **Specialist në Sektorin e Projekteve dhe Zbatimit të Kontratave Ndërtimore në Drejtorinë e Prodhimit** një kandidat profesionist, i cili duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Aftësitë e kërkuara:

Arsimimi	<ul style="list-style-type: none">Të jetë diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në degën Inxhinieri Ndërtimi në një nga universitetet e akredituara në vend apo në universitete të tjera të huaja;
Eksperiencë pune	<ul style="list-style-type: none">Preferohet të ketë të paktën 3 vjet eksperiencë pune në profesion, në hartimin e projekteve, zbatimin e investimeve dhe koordinimin e punës për zbatimin e kontratave;
Cilësitë	<ul style="list-style-type: none">Njohuri të mira të legjislacionit për dokumentacionin ligjor – teknik që kërkohet në fushën e ndërtimit.Njohuri të mira për shoqëritë tregtare, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.Kanë avantazh aplikantët që zotërojnë gjuhën angleze;Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikime me gojë/shkrim, të jetë i përshtatshëm për të punuar në grup, si dhe i hapur ndaj sfidave të ndryshme që mund të lindin nga procesi i punës;Njohuri të mira të programeve kompjuterike dhe programeve të tjera në fushat e inxhinierisë së ndërtimit si Autocad etj.;